

# PËR SHËRBIME MË TË MIRA

PAGUAJ  
TATIMIN NË PRONË

[WWW.TATIMINEPRONE-RKS.ORG](http://WWW.TATIMINEPRONE-RKS.ORG)



Për më shumë informata:  
[WWW.TATIMINEPRONE-RKS.ORG](http://WWW.TATIMINEPRONE-RKS.ORG)



MINISTRIA E FINANCAVE  
MINISTARSTVO ZA FINANCIJE  
MINISTRY OF FINANCE

## ÇKA ËSHTË TATIMI NË PRONË?

Tatimi në pronë është taksë vjetore komunale që prona rët e pronave ia paguajnë komunës në të cilën ndodhet prona. Me tatim në pronë ngarkohen të gjitha prona e paluajtshme nën apo mbi nivelin e tokës. Shkalla e tatimit përcaktohet me vendim të Kuvendit Komunal dhe nuk mund të jetë nën shkallën minimale të tatimit të përkufizuar me Ligjin për Tatimin në Pronë.

### TATIMI I PAGUAR



VLERA E  
TATUESHME



SHKALLA E  
TATIMIT

## SI SHFRYTËZOHEN TË HYRAT NGA TATIMI NË PRONË?

Tatimi në pronë grumbullohet në buxhetin komunal i cili përbën më shumë se 30% të të hyrave vetanake të krijuara nga komuna. Çdo vit, përmes dëgjimeve publike buxhetore, zyrtarët komunal dhe qytetarët vendosin së bashku se si ti ndajnë këto fonde. Bazuar në këto vendime të përbashkëta, fondet shfrytëzohen për një sërë përmirësimesh në komunë duke përfshirë rrugët, ndriçimin publik, parqet dhe këndet e lojërage. Nëse dëshironi më shumë informata për tatimin në pronë në komunën tuaj, viziton [www.tatiminepronë-rks.org](http://www.tatiminepronë-rks.org), uebfaqen e komunës suaj ose shkonit në Zyrën Komunale për Tatim në Pronë.

## SI TA PAGUANI TATIMIN NË PRONË?

Fatura e tatimit në pronë dërgohet tek ju përmes PTK-së ose zyrtarëve komunal. Për ta paguar tatimin në pronë, duke pasur faturën me vete, shkonit në njëren nga bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.

Afat i fundit për pagesën e këstir të parë është 30 qershor, ndërsa për këstin e dytë është 31 dhjetori. Paguani tatimin me kohë për t'iu shhangur kamatës dhe ndëshkimit. Pas afatit të pagesës do të zbatohet ndëshkimi prej 10%. Përveç ndëshkimit, do të zbatohet kamata prej 1% për çdo muaj. Nëse keni borxhe nga vitet e mëhershme, paguani tani që t'i shhangeni kamatës.

Ju mund ta merrni certifikatën e pagesës në Zyrën Komunale të Tatimit në Pronë disa ditë pas pagesës. Sigurohuni që ta keni me vete edhe letërnjoftimin.

## PSE ËSHTË ME RËNDËSI TË PAGUHET TATIMI NË PRONË?

Duke paguar tatimin në pronë ju bëheni pjesë e përpjekjeve për ta përmirësuar cilësinë e jetesës në lagjen dhe komunën tuaj. Të gjithë ata që paguajnë tatimin në pronë rregullisht luajnë rol të rëndësishëm në ndryshimin e komunës dhe zhvillimin e tërë vendit!

